

PROJEKT PYLLEZIMI

PYLLEZIME ME LLOJIN PISHE E ZEZE DHE AKACIE.

**PERGATITI
INXH.LUTFI MIFTARI**

GUSHT 2014

PROJEKT PYLLEZIMI

Emri i objektit:	Llapush-Kete
Ekonomia pyjore	Gurre
Fshati	Gurre
Ngastra/nengastra	16.A;17.A;18.AB;22a

I- Qellimi i pyllezimit dhe karakteristikat stacionale

- **Qellimi i pyllezimit**

Qellimi i pyllezimit eshte parandalimi i erozionit siperfaqesor dhe rreshqitjes se tokes ne te dy anet e perroit te fshatit gurre duke nderthurur njekohesisht masat hidroteknike me ato biologjike.

TE DHENA TE PERGJITHSHME TE OBJEKTIT

- **Pozicioni i objektit**

Siperfaqja e cila eshte zgjedhur per tu pyllezuar ka keto kordinata gjeografike

N 39° 49 039'

E 20° 17 098'

Altituda: 590 m

II Zbatimi i punimeve

- **Zgjedhja e llojeve**

Per zgjedhjen e llojeve pyjore do te bazohemi ne kriterin e ekologjise se krahasuar. Duke qene se **Akacia (Robinia pseudoacacia)** eshte nje lloj mjaft i mire per stabilizimin e terreneve te rreshqitshme atehere rekomandojme qe ky lloj te perdoret per pyllezim. Nisur edhe nga ekzistenca e disa drureve akacie mendojme se ky lloj eshte mjaft i pershtatshem per pyllezim.

- **Veçoritë morfologjike dhe ekologjike të akacies (Robinia pseudoacacia L)**

Akacia eshte nje lloj qe rritet ne zonen e ulet dhe te mesme (Castanetum dhe Lauretum).U pershtatet çdo lloj toke perve ç atyre argjilore te renda dhe torfike.Preferon toka te lehta e mesatarisht pjellore me reaksion acid ose pak acid. Ne saje te sistemit rrenjor te zhvilluar I reziston ererave te forta e mberthen token duke e ruajtur nga erozioni.Ky lloj pyjor ndihmon ne pasurimin etokes me azot i cili perqendrohet ne rrenjet e saj nga bakteret Bacillus radicola. Frutifikimi fillon ne moshen 10-20 vjeçare dhe farat prodhohen çdo vit. Farat piqen ne vjeshte por mbledhja e tyre mund te behet edhe ne dimer.Aftesia mbirese eshte 70-80% dhe ruhet 2-3 vjet ne ambient te thate.Nje kilogram fara permban 50000 fara.

- ***Temperamenti***

Eshte lloj dritedashes me kerkesa mesatare kundrejt lageshtise.E permirson token dhe rritet shpejt deri ne moshen 45-60 vjeç.

- ***Kultivimi***

Ne fidanishte fara mbillet ne vija te ngushta.Mbjellia duhet bere nga fundi I muajit Prill per te menjanuar ngricat e mevonshme.Filizat brenda vitit arrijne lartesine 60-100 cm dhe jane te afte per tu mbjelle ne vendin e percaktuar per pyllezim.Ne pyllezime mbjellia kryhet me fidane ose me fare.Kur mbjellia kryhet me fare ne te gjithë siperfaqen perdoren 6-8 kv fare/ha dhe kur behet ne rrjeshta duhen 2-3 kv. Ne mbjelliet me fidane perdoren filiza 1-2 vjeçare (1F+1SH).Kur mbjelliet kryhen ne stacione te thata e ne toka pak a shume kompakte, keshillohet krasitja e kurores per ta ekuilibruar me sistemin rrenjor. Distanca e mbjellies midis fidaneve 15.-2m.

- ***Punimi i tokes***

-Me sheshe:

Ne zonat kodrinore sheshet behen ne forme katrori ose katerkendeshi 1x1m deri 2x3m ne nje largesi 3-5m nga njeri-tjetri. Gropat hapen 40x40x40 cm.

-Me gradona:

Per terrene te pjerret e shume te ceket perdoret pyllzimi me gradona. Gradonat hapen 80 cm te gjere dhe 2-3m larg njeri-tjetrit. Ne token e gradonit te punuar 40 cm thelle hapen gropat 40x40x40 cm ne largesi 1-1.5m.

-Me gropa:

Eshte punimi me i lehte per tu zbatuar ne format e terrenit sidomos kur eshte i sheshte. Largesia midis gropave ndryshon sipas skemes se pyllzimit. Gropat hapen 40-50cm te thella dhe te gjera e te gjata 60x60cm.

Ne objektet e pyllzuara te destinuar per prodhimin e lendes drusore mbillen 2500-3000 fidane/ha ne nje largesi 2x2m ose 2x1.5m.

Ne rastin e mbjellieve me sheshe ose me gradona largesia ndryshon ne varesi te pjerresise se terrenit, kurse midis fidaneve largesia merret 1-2m.

- **Zgjedhja e formulave dhe skemave te pyllzimit**

Propozojme qe pyllzimi te jete monokulture pra me nje formule **1.0 Akacie (Robinia pseudoacacia)**, kurse skema e zgjedhur per pyllzim te jete **2 x 2.5 m** pra gjithsej **2000 fidane per hektare**.

- **Menyra e mbjellies**

Terreni ne pergjithsi eshte i pjerret me nje pjerresi 25-30 grade, prandaj rekomandojme qe pyllzimi te kryhet me gradona me gjeresi 80cm dhe me sheshe me dimensione 0.8x0.8x0.4m me punim qilizem 40 cm.

- **Pregatitja e tokes**

Para se te kryhet mbjellia e fidaneve lind nevoja qe terreni te pastrohet nga shkurret apo ferrat Me pas puna do te vazhdoje me hapjen e gradonave dhe me pas me pregatitjen e shesheve me dimensione 0.8x0.8x0.4 m.

- **Koha e mbjellies**

Mbjellia e fidaneve behet kur pushon periudha e vegjetacionit e konkretisht ne fund te muajit Tetor dhe ne fillim te Nentorit, ose dy jave para fillimit te vegjetacionit ne Pranvere. Futen rrenjet e fidanit thelle ne grope dhe mbulohen me dhe deri 2 cm mbi qafen e fidanit. Ngjishet toka ne grope per te siguruar nje kontakt sa me te mire te rrenjeve me token. Fidanet e akacies duhet te plotesojne disa kushte teknike te cilat jane:

-te kene sistem rrenjor te zhvilluar, te pademtuar e pa pjese te thata.

-trupi te jete i drunjezuar,i pademtuar,i drejte me sythe te zhvilluar normalisht dhe te pacelur

-gjethet te kene ngjyren karakteristike te kultivarit dhe fidani te jete i paprekur nga semundjet apo insektet.

Fidanet futen ne grope dhe mbulohen me dhe deri mbi 2 cm nga qafa e rrenjes se fidanit. Hidhet pak pleh oreganik dhe me pas perseri dhe, i cili ngjeshet ngadale deri sa te mbushet gropa plotesisht.

▪ **Mbrojtia e objektit**

Mbrojtia e objektit te pyllzuar do te kryhet nga ana e komunitetit te zones.Per vete pozicionin ku ndodhet objekti nuk eshte e nevojshme rrethimi i siperfaqes.

▪ **Sherbimet kulturele dhe zevendesimet**

Eshte mire qe pas mbjellies te kryhen sherbime kulturele. Ne vitet e para pas mbjellies duhen kryer prashitje. Zakonisht kryhen 3 prashitje vitin e pare,2 prashitje vitin e dyte dhe 1 prashitje vitin e trete. Ne pyllezimet e reja kryhet nje pastrim ne moshen 5 vjeçare duke hequr druret qe nuk jane te zhvilluar sa duhet.Krasitja eshte nje tjetër proces qe kryhet njekohesisht me pastrimin.Lartesia e krasitjes se drureve duhet te jete 4-5m. Koha e kryerjes se krasitjes eshte fundi i dimrit. Ne rast se ka fidane te cilet nuk kane zene mire lind nevoja e zevendesimit te tyre duke i shkukur dhe duke mbjelle fidane te rinj. Shkalla e zenies se fidaneve ne objekt duhet te jete mbi 85 %.

▪ **Qeverisja e akacies**

Pyjet e akacies kane nje fuqi lastarizuese te larte dhe per kete qellim trajtohen si cungishte e thjeshte.Cikli i prodhimit dnryshon sipas nevojave ekonomike.Nese duma te prodhojme hunj cikli i prodhimit eshte 4-5 vjet,nese duam te prodhojme dru zjarri cikli i prodhimit eshte 7-8 vjet dhe nese duam te prodhojme lende te holle cikli i prodhimit eshte 10-20 vjet.

Shfrytezimi i siperfaqes se mbjelle me akacie behet me prerje rrah te drureve ne siperfaqe. Prerja behet njesh me token duke kryer pastrimin nga mbeturinat drusore. Cungjet pastrohen 20 cm rreth e qark qe lastaret e rinj te dalin te forte si dhe te kryhet gervishtja e ceket e tokes per plagosjen e rrenjeve. Mbas 3-4 ciklesh prodhimi cungjet e humbasin aftesine lastarizuese dhe duhet kryer rimbjellia.

Skema e objektit te pyllzimit








Figura : Pamja e objektit ku do kryhen pyllëzimet me akacie

Ashtu siç shihet edhe nga pamjet verehet një erozion i theksuar sipërfaqësor dhe në thellesi të tokës i cili bën të nevojshëm pyllëzimin e sipërfaqes me qëllim parandalimin e humbjeve të metejshme të tokës si rezultat i gerryrjeve.



PREVENTIV

PER

1 Ha pyllzime me Akacie

Emri i vendit: **Gurre**

Siperfaqja **8000 m²**

Numri i ngastres dhe kodi identifikues **22b**

Shenja ne manual	Emertimi i Punimeve	Njesia e matjes	Volumi i punes	Norma	Dite pune	Paga per dite pune	Shuma leke
225/1	Piketim gradonash	ml	1200	900	1.3	680	906.7
225/2	Piketim sheshesh me nivele	cope	2000	180	11.1	680	7548
226/2	Ndertim gradonash 80 cm gjeresi me qilizem 40cm	ml	1200	20	60.0	680	40800.0
227/2	Pregatitje sheshesh 0.8x0.8x0.4	cope	2000	25	80	680	54400
224/5	Mbjellie fidanesh ne gropa 50x50x50 cm	cope	2000	60	33.3	680	22644
228/1	Transport fidanesh fletore 1-2 vjecare(pa toke) deri 450 m largesi	cope	2000	200	10	680	6800
	SHUMA 1						133098.7
	Blerje fidanesh	cope	2000			30	60000
	Transport auto fidanesh ne dist mbi 150 km	cope	2000			10	20000
	SHUMA 2						213098.7
	Shpenzime administrative 3%						6393
	SHUMA 4						219491.7

	Tatim ne burim 10%						21949
	Totali i financuar nga projekti						241440.7
	Kontributi i shoqates 20%						48288

Vlera per 0.5 ha pyllzime me akacie qe projekti i financon shoqates do te jete:

$$213098.7 \times 68 \text{ ha} = 14490711 \text{ leke.}$$

Ekonomia Pyjore : **Balgjaj**

Ngastra : **22,18,15,16,17.ab;16ab**

Objekti Balgjaj 1

PROJEKT-PYLLEZIMI

- Qellimi i pyllezimit dhe karakteristikat stacionale

- **Qellimi i pyllezimit**

Pyllezimi do te kryhet ne dy siperfaqe te veçuara. Siperfaqja e dyte e zgjedhur per pyllezim eshte ne te dy krahet e balgjaj 1 rigjenerimin e siperfaqeve te degraduara. Ne kete siperfaqe nuk gjenden drure pyjore dhe bimesia e vetme qe gjendet eshte ajo barishtore e tipit graminacea. Mendojme qe per pyllezim te perdorim llojin Pishe te zeze.

TE DHENA TE PERGJITHSHME TE OBJEKTIT

- **Pozicioni i objektit**


Siperfaqja e cila eshte zgjedhur per tu pyllezuar ka keto kordinata gjeografike


N 39° 53 605'

E 20° 20 884'

Altituda: 307 m

Siperfaqja qe do pyllzohet me akacie ka nje madhesi prej 320 m², kurse siperfaqja qe do pyllzohet me Pisha E ZEZE ka nje madhesi prej 3800 m². Ne terren jane kryer matjet te cilat ne menyre skematike jepen si me poshte:





- **Perdorimi i deritanishem**

Siperfaqja e zgjedhur per pyllzimin me akacie eshte boshe vetem me bimesi barishtore. Kurse ne siperfaqen ku do mbillen Pishat gjenden vetem disa drure te llojit Selvi (*Cupresus sempervirens*) dhe si bimesi barishtore gjenden ato te familjes graminacea.

II Zbatimi i punimeve

- ***Temperamenti***

Eshte lloj dritedashes me kerkesa mesatare kundrejt lageshtise. E permirson token dhe rritet shpejt deri ne moshen 45-60 vjeç.

- ***Kultivimi***

Ne fidanishte fara mbillet ne vija te ngushta. Mbjellia duhet bere nga fundi i muajit Prill per te menjanuar ngricat e mevonshme. Filizat brenda vitit arrijne lartesine 60-100 cm dhe jane te afte per tu mbjelle ne vendin e percaktuar per pyllzim. Ne pyllzime mbjellia kryhet me fidane ose me fare. Kur

mbjellia kryhet me fare ne te gjithë siperfaqen perdoren 6-8 kv fare/ha dhe kur behet ne rrjeshta duhen 2-3 kv.

Ne mbjelliet me fidane perdoren filiza 1-2 vjeçare (1F+1SH). Kur mbjelliet kryhen ne stacione te thata e ne toka pak a shume kompakte,keshillohet krasitja e kurores per ta ekuilibruar me sistemin rrenjor.Distnaca e mbjellies midis fidaneve 15.-2m.

▪ **Pisha e zeze (pinus nigra)**

Ne optimumin e arealit te saj arrin nje lartesi 20-25m dhe nje diameter 1.5m.Sistemi i saj rrenjor eshte i forte e i thelle mbi 1m.Kerrelli eshte i drejte,cilindrik,i zhveshur nga deget ne pjesen e poshtme.Kurora ka degezim te rregullt,e shtrire,qerthullore ne form ombrelle.Halat nga 2-3 se bashku ne nje kellef,8-20 cm te gjata dhe 1.5-2 mm te gjera,te perdredhura me ngjyre te gjelber te qarte.Lulezon ne Prill-Qershor.Frutifikon ne moshen 15-20 vjeçare dhe ne pergjithsi frutifikon çdo vit.Ne moshe te re ka rritje te shpejte. Farat piqen ne vjeshten e vitit te trete dhe bien natyrshem ne pranveren e vitit te ardhshem.

-Ekologjia

Takohet ne zonen fitoklimatike Lauretum,por mund te ngjitet edhe ne faqet e ngrohta ne zonen Castanetum.Takohet ne tokat ranore hde ne te gjitha nentipet e tokave te hinjta kafe. Eshte lloj mesdhetar, kalcifug,nuk ka kerkesa te medha ndaj tokes,mjafton te jete pak e shkrifet dhe e fresket qe te lehtesojë depertimin e rrenjeve.

-Temperamenti

Eshte lloj kserofil me temperament dritedashes.Nuk u qendron shume ererave te detit.Rritet shpejt.

Perdoret per pyllzimin e terreneve te zhveshura vetem ose i perziere me lloje te tjere halore ne grupe ose ne rrypa.

-Kultivimi

Mbjelliet ne pyllzime behen drejtperdrejt me fare ose me fidane.Per mbjellien me fare(fluturimthi) duhen 60-70kg fistike,ne rrypa 40-50 kg fistike,ne vija ose ne gropeza 15-25 kg fistike.Mbulimi i fares kryhet deri ne thellesine 2-3 cm,ndersa ne ranishtet bregdetare 4-5 cm thelle.Kur del e nevojshme te kryhen mbjellie me fidane perdoren filiza 1 vjeçare me rrenje me toke. Ne kete rast filizat pregatiten ne vazo. Mund te perdoren edhe fidane te shperngulur (1F+2SH ose 2F+2SH). Largesia midis fidaneve percaktohet sipas tokes dhe qellimit dhe shkon nga 1.5m deri 2-3m.

-Sherbimet kulture

Si sherbime te para kulture mbjelliet me pihse te bute kane nevojë per prashitje,heqje barerash te keqia,pastrime dhe çlirime.Pastrimet jane te nevojshme ne rastet kur mbjellia me fare eshte e pjesshme per te menjanuar mbytjen e filizave nga shkurret dhe barerat.

Çlirimet jane te nevojshme ne mbjeliet e dendura.Fillohen ne vitin e dyte dhe ne vitin e trete e te katert dhe duhet te lihen jo me shume se 3000-4000 fidane/ha.

- **Zgjedhja e formulave dhe skemave te pyllzimit**

Propozojme qe pyllzimi te jete me nje formule 1.0 Akacie per siperfaqen 320 m² anash kanalit dhe 1.0 Pishes e bute ne te dy krahet e fushes se sportit. Skema e zgjedhur per pyllzimit te jete **2 x 1.5 m** per akacien (3333 fidane/ha) dhe **2x2m** (2500 fidane/ha) per Pishen e bute .

- **Menyra e mbjellies**

Terreni eshte plotesisht i sheshte e per rrjedhoje mbjellia e fidaneve do kryhet me gropa.Fidanet e Pishes do mbillen me buke dheu.

Per akacien gropat do kene permasa 40x40x40cm kurse per Pishen e bute 30x30x30cm. Mbjellia do te kryhet gjate muajit Nentor-Dhjetor duke perdorur fidane 2 vjeçare me qellim qe te zene sa me mire si dhe te kryejne sa me shpejt funksionin mbrojtës te tokes dhe rekreativ.

- **Pregatitja e tokes**

Para se te kryhet mbjellia e fidaneve lind nevoja qe terreni te pastrohet nga shkurret apo ferrat Me pas puna do te vazhdoje me piketimin e hapjen e gropave per mbjellien e fidaneve 2 vjecare te akacies dhe pishes se bute.

- **Koha e mbjellies**

Per vete kushtet klimatike te zones rekomandojme qe mbjellia e Akacie dhe Pishes se bute te kryhet gjate muajit (Nentor) ne vitin 2009. Kjo do ti jape mundesi fidaneve qe te zhvillohen me se miri duke arritur qe te adaptohen me kushtet e motit dhe ti rezistojne ngricave te dimrit. Fidanet e drureve pyjore duhet te plotesojne disa kushte teknike te cilat jane:

-te kene sistem rrenjor te zhvilluar, te pademtuar e pa pjese te thata.

-trupi te jete i drunjezuar,i pademtuar,i drejte me sythe te zhvilluar normalisht dhe te pacelur

-gjethet te kene ngjyren karakteristike te kultivarit dhe fidani te jete i paprekur nga semundjet apo insektet.

Fidanet futen ne grope dhe mbulohen me dhe deri mbi 2 cm nga qafa e rrenjes se fidanit. Hidhet pak pleh organik dhe me pas perseri dhe, i cili ngjeshet ngadale deri sa te mbushet gropa plotesisht.


- **Mbrojtia e objektit**

Mbrojtia e objektit te pyllezuar do te kryhet nga ana e komunitetit te zones. Siperfaqja e zgjedhur per pyllezim nuk perdoret si kullote dhe per kete arsye ruajtja e saj nga bagetite eshte thuaje e garantuar.

- **Sherbimet kulturele dhe zevendesimet**

Rekomandohet qe sherbimet kulturele te kryhen te pakten per nje periudhe 2-3 vjeçare. Ne vitin e pare te mbjellies rekomandojme te kryhen 3 prashitje, ne vitin e dyte 2 prashitje dhe 1 prashitje ne vitin e trete. Ne rast se ka fidane te cilet nuk kane zene mire lind nevoja e zevendesimit te tyre duke I shkukur dhe duke mbjelle fidane te rinj. Shkalla e zenies se fidaneve ne objekt duhet te jete mbi 85 %.

Skema e mbjellies me fidane Akacie



Skema e mbjellies me fidane Pise te bute



	Shpenzime administrative 3%						5029
	SHUMA 3						172674.8
	Tatim ne burim 10%						17267
	Totali i financuar nga projekti						189,941.8
	Kontributi i shoqates (natyre,ruajtje) 20%						37,988